



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR

VENDIM
Nr.5, datë 14.06.2024

“Për mbledhjen e të dhënave dhe dokumentave të nevojshme nga Institucionet Shtetërore e ato të Pavaruara, Agjencitë Ekzekutive Ligjzbatuese në funksion të qëllimit dhe objektit të punës së Grupit të Ekspertëve pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar”

Bazuar në nenin 24 e vijues të Regullores së Kuvendit dhe në pikën XI paragrafi 2, të vendimit nr. 50/2024 të Kuvendit të Shqipërisë “Për krijimin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për thellimin e reformave për Mirëqeverisjen, Sundimin e Ligjit dhe Antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian”, me propozim të kryetarit Komisioni i Posaçëm

VENDOSI:

1. T’u kërkojë Kuvendit, Ministrisë së Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Ministrisë së Shtetit dhe Kryenegociator, Ministrisë së Shtetit për Pushtetin Vendor, Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të tjera shtetërore që të venë në dispozicion të Grupit të Ekspertëve dokumenta pune, analiza, strategji, plane veprimi dhe të dhëna të ndryshme që shërbejnë për përmbushjen e objektit të veprimtarisë së këtij komisioni
2. Të autorizojë kryesinë e Komisionit për t’u komunikuar institucioneve përkatëse të mësipërme vendimin e Kuvendit, objektin e punës së komisionit, organizimin dhe kohën e veprimtarisë së tij, si dhe të organizojë gjithë procesin e njoftimit, administrimit të të dhënave dhe përgatitjen e bazës përkatëse të të dhënave për njohje e përdorim nga grupet e ekspertëve dhe Sekretariatit Teknik.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

FATMIR KHAFAJ

Miratuar me 14.06.2024